

Këshilltar ligjor i Gjykatës së Lartë

Edlira Llango ka lindur në Çorovodë, më 6 Maj 1980. Është e martuar dhe nëna e një djali.

Në vitet 1998-2004 ka kryer studimet universitare për drejtësi pranë Universitetit të studimeve të Romës, “La Sapienza”, Itali. Gjatë kësaj periudhe ka ndjekur disa kurse universitare shumëdisiplinor për edukimit dhe zhvillim: “*Përrjashtimi social: paragjykimet dhe diskriminimet*” (Viti akademik 2003-2004); “*Azili Politik: Nga Konventa e Gjenevës në Kushtetutën Evropiane*” (Viti akademik 2003-2004); “*Emigracioni dhe Azili Politik: Bashkimi Evropian dhe Rajoni i Mesdheut*” (Viti akademik 2004-2005).

Në Vitin akademik 2004-2005 ka kryer studimet pasuniversitare në “Mbrotjen Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut”, pranë Universitetit të studimeve të Romës, “La Sapienza”, Itali.

Në periudhën Maj 2006 – Dhjetor 2007 ka punuar si juriste pranë Komunës Qendër Skrapar. Në periudhën 2008-2013 ka ushtruar profesionin pranë sektorit privat. Nga Shkurti i vitit 2014 deri në Mars të vitit 2016 ka qenë Drejtor i Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik. Në periudhën Gusht 2018 – Shtator 2019 ka qenë Drejtor i Drejtorisë së Legjislacionit pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Në vitin akademik 2019 – 2020 ka ndjekur studimet pranë Shkollës së Magjistraturës, në profilin Këshilltar Ligjor.

Me Vendimin nr. 555, datë 12.11.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është emëruar Këshilltare Ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor, pranë Gjykatës së Lartë.